



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101

MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE E BARRËS SIGURUESE KUOTA/AKSIONE)

Nr. repertori: 1437

Nr. koleksioni: 791

Tirane më 24/02/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodí Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023051400081845206

*Akti material përbëhet nga 14 fletë



A2023051400081845206

MARRËVESHJE BARRE SIGURUESE

MBI KUOTAT

ndërmjet

BLESSED INVESTMENT SH.P.K.,

MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.

si Barrëdhënës

dhe

GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIF si Barrëmarrës

Sot, më 24/02.2023 në Tiranë, përpara meje Noter Publik, Alket Mançka, u paraqitën palët e mëposhtme, të cilët do të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese si më poshtë:

Kjo Marrëveshje Siguruese (referuar në vijim si “Marrëveshja” ose “Marrëveshja e Barrës Siguruese” lidhet në Tiranë midis:

BLESSED INVESTMENT SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar, mbajtëse e NIPT L71423028S dhe me seli në Rr. Themistokli Gërmenji, Nr. 6, Kati 1, Tiranë, 1001, Shqipëri, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga përfaqësuesi ligjor **Ana Lleshi**, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036384557 dhe nr. personal I15507055G

dhe

MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar, mbajtëse e NIPT J91306009Q dhe me seli në Rr. Nikolla Jorga, Nr 18/2, Tirana, 1001, Albania, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga përfaqësuesi ligjor **Ida Mezini**, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036980443 dhe nr. personal H15724048V

(referuar në vijim si “Barrëdhënësit”); dhe

GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV, shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Luksemburgut, me seli të regjistruar në adresën :[] , 4, Boulevard Royal, L-2449 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg, përfaqësuar përmes prokurës së lëshuar më datë 2 Shkurt 2023, nga Z.Aigest



A2023051400081845206

Milo, lindur më 4 Prill 1986 , në Tiranë, me numër pasaporte BJ9458059, dhe nr. personal. I60404066V (referuar në vijim si "**Barrëmarrësi**"),,

dhe secili prej subjekteve ligjore të renditura më sipër, quajtur veçmas si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët",

HYRJE:

DUKE PATUR PARASYSH SE:

- A. Në mbështetje të Marrëveshjes së Kredisë në lidhje me Impiantin Fotovoltaik AC 50 MË në Topojë, qarku Fier, Shqipëri e datës 23.02.2023, lidhur midis Barrëmarrësit, dhe SPV BLUE 1 SH.P.K. (në cilësinë e Huamarrësit) (më tej "Marrëveshja e Kredisë") Barrëmarrësi i ka vënë në dispozicion Huamarrësit një hua deri në një shumë prej EUR 31,000,000 (tridhjetë e një milionë Euro);
- B. Është kusht paraprak i Marrëveshjes së Kredisë që të nënshkruhet kjo Marrëveshje me qëllim krijimin e një barre në formën e Barrës Siguruese (sipas përkufizimit me poshtë) mbi Kolateralin (sipas përkufizimit me poshtë) nga Barrëdhënësit, në favor të Barrëmarrësit;
- C. Me qëllim sigurimin e detyrimeve aktuale dhe të ardhshme që Huamarrësi ka ose mund të ketë ndaj cilësdo Pale Financiare duke përfshirë Barrëmarrësin sipas Dokumenteve Financiare, Barrëdhënësit bien dakord që, ndër të tjera, të hyjë në këtë Marrëveshje me qëllim sigurimin e përmbushjes së Detyrimeve të Siguruara (sipas përkufizimit me poshtë)

BAZUAR NË SA MË SIPËR, Palët, me qëllimin për t'u angazhuar ligjërisht, bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1. Përkufizimet

Kudo janë përdorur në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe në Hyrje), ternat në vijim kanë kuptimet e mëposhtme:

"**Dite Pune**" do të ketë të njëjtin kuptim si në Marrëveshjen e Kredisë;

"**Kolaterali**" do të thotë kuotat dhe të gjitha të drejtat e lidhura në kapitalin e Huamarrësit të cilat zotërohen dhe mund të zotërohen në të ardhmen nga Barrëdhënësit;

"**Vendosja**" dhe/ose "**Regjistrimi**" (përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme) është përkatësisht vendosja, krijimi dhe regjistrimi i Barrës Siguruese (ose i çdo ndryshimi apo shtese të saj) mbi Kolateralin, në përputhje me këtë Marrëveshje përmes:

- a) regjistrimit të Barrës Siguruese në Regjistrin e Barreve Siguruese (RBS);
- b) lëshimit të konfirmimit të regjistrimit dhe certifikatës përkatëse nga RBS-ja, që vërteton dhënien (ose ndryshimin apo shtimin) dhe regjistrimin e Barrës Siguruese objekt të kësaj Marrëveshjeje; dhe
- c) regjistrimin e Marrëveshjes së Barrës Siguruese pranë QKB-së (përcaktuar më poshtë), në llogarinë përkatëse të Shoqërisë;

ku "**Vendos**", "**Vendosje**", "**Regjistroj**" dhe "**Regjistrim**" interpretohen sipas përkufizimit më lart.

"**Marrëveshja e Kredisë**" ka kuptimin që i është dhënë në preambulën (A) më sipër

"**Dokumente Financiare**" do të kenë të njëjtin kuptim të parashikuar në Marrëveshjen e Kredisë;

"**Palë Financiare**" do të ketë të njëjtin kuptim të parashikuar në Marrëveshjen e Kredisë;



A2023051400081945206

"**Ligji për Barrët Siguruese**" është Ligji Nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", ndryshuar herë pas here;

"**Barrë**" nënkupton çdo hipotekë, peng, garanci, transferim të të drejtave, kufizim, barrë siguruese (nëse është krijuar me ligj), transferim me mbajtjen e titullit ose transaksione të tjera sigurie, ose qira, blerje me këste ose qira afatgjatë, kolateral financiar ose ndonjë e drejtë me efekt të ngjashëm e një pale tjetër të tretë;

"**Rast Ekzekutimi**" do të thotë një Rast Mospërmbushjeje;

"**Rast Mospërmbushjeje**" do të kenë të njëjtin kuptim të parashikuar në Marrëveshjen e Kredisë;

"**QKB**" nënkupton Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri;

"**RBS**" është Regjistri i Barrëve Siguruese në Shqipëri i krijuar sipas Ligjit për Barrët Siguruese

Të drejtat e lidhura" do të thotë:

- a) dividendët, interesat dhe të ardhurat e tjera të paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo kuotë pas datës së kësaj Marrëveshjeje;
- b) çdo kuotë, letër me vlerë, e drejtë, para ose pronë që grumbullohet ose ofrohet në çdo kohë (qoftë me anë të riblerjes, bonusit, preferencës, të drejtës së opsionit, zëvendësimit, këmbimit ose formë tjetër) në lidhje me ndonjë prej Kuotave (duke përfshirë por pa u kufizuar në të ardhurat nga shitja);
- c) të gjithë dividendët, interesat ose të ardhurat e tjera në lidhje me çdo aktiv të tillë siç përmendet në nën-paragrafin (ii) më sipër, dhe
- d) të gjitha të drejtat, përfitimet dhe avantazhet tani ose në çdo kohë në të ardhmen që rrjedhin ose janë të rastësishme për cilindo prej Kuotave, duke përfshirë të gjitha të drejtat e votës në lidhje me Kuotat, të cilat mund të përdoren si për mbledhjet e zakonshme dhe për ato të jashtëzakonshme të asamblesë së përgjithshme të Huamarrësit";

"**Detyrimet e Siguruara**" janë të gjitha detyrimet që bëhen të shlyeshme në çdo moment, që i përkasin ose që lindin mbi Huamarrësin për çdo Palë Financiare sipas Dokumenteve Financiare, qofshin ato të tashme ose të ardhshme, aktuale ose të kushtëzuara (dhe nëse janë shkaktuar vetëm ose bashkërisht dhe qoftë si principal ose garanci ose në ndonjë cilësi tjetër) (përfshirë në përputhje me klauzolën 2.2 (Zmadhimi);

"**Periudha e Sigurisë**" është periudha që fillon nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje e përfundon në datën kur:

- a) të gjitha Detyrimet e Siguruara janë shlyer plotësisht dhe përfundimisht; dhe
- b) asnjë Palë e Siguruar nuk është palë në ndonjë angazhim, obligim ose detyrim (aktuale ose kontingjente) për të bërë paradhënie ose për t'i ofruar kushte të tjera financiare Huamarrësit në përputhje me Dokumentet Financiare;

"**Barra Siguruese**" është e drejta e Barrëmarrësit, e ushtruar mbi Kolateralin, si të tashëm, ashtu dhe të ardhshëm, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, e Vendosur dhe e Regjistruar në përputhje me këtë Marrëveshje, e cila shërben gjatë Periudhës së Sigurisë si garanci për Detyrimet e Siguruara.

"**Palë e Siguruar**" do të ketë të njëjtin kuptim të parashikuar në Marrëveshjen e Kredisë;

"**Kuota**" nënkuptojnë dy kuotat e zotëruara nga Barrëdhënësit që përfaqësojnë 100% të kapitalit të SPV BLUE 1 SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë në: Rruga Themistokli Gërmenji", Ndërtesa Nr. 1. me numër regjistrimi (NUIS) : M11512005P (përveç referimit si "Huamarrësi", këtu referuar



A2023051400081845206

gjithashtu si "Shoqëria", të dyja termat në këtë Marrëveshje janë të këmbyeshme), siç specifikohet sipas ekstraktit të QKB-së bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje. Kuptohet se kuotat janë ato që secili prej Barrëdhënësve të mësipërm zotëron në Shoqëri dhe, siç e kërkon konteksti, çdo kuotë tjetër në kapitalin e Shoqërisë që ndonjë nga Barrëdhënësit mund të zotërojë në çdo kohë në të ardhmen me përfitim ose në të cilin Barrëdhënësit mund të kanë ndonjë interes; dhe

"QKB" nënkupton Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

Termat të cilat fillojnë me gërmë të madhe dhe për të cilat nuk është dhënë një përkufizim do të këtë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Kredisë.

1.2. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

- a) çdo Palë interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe pasardhësit në titull, cesionarët e lejuar dhe marrësit e lejuar të t drejtave.
- b) përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas; fjalët që tregojnë persona përfshijnë individë, korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë; dhe referencat ndaj një personi përfshijnë edhe pasardhësit dhe marrësit e lejuar të t drejtave;
- c) referenca ndaj një marrëveshjeje, duke përfshirë pa u kufizuar në Marrëveshjen e Kredisë, duhet interpretuar si referencë ndaj asaj marrëveshjeje siç mund të jetë amenduar, ndryshuar, shtuar, rinovuar apo rregulluar herë pas here, duke përfshirë (pa u kufizuar) amendimet, ndryshimet, shtesat, rinovimet dhe rregullimet lidhur me identitetin e Barrëmarrësit dhe/ose natyrën ose shumën e Detyrimeve të Siguruara.
- d) referenca ndaj një ligji, rregulloreje apo statuti interpretohet si referencë ndaj atij ligji, rregulloreje apo statuti, siç mund të jetë amenduar, ndryshuar apo shtuar herë pas here;
- e) krerët janë vendosur vetëm për qëllime reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- f) "përfshirë" dhe "përfshin" interpretohen së bashku me togfjalëshin "pa kurrfarë kufizimi" edhe kur nuk ndiqet nga ky i fundit.
- g) përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, detyrimet e Barrëdhënësve sipas kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen se zbatohen për Barrëdhënësit individualisht dhe/ose bashkërisht.

2. DEKLARIMET DHE GARANCITË

2.1. Deklarimet dhe Garancitë

Që nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe në datën e krijimit regjistrimit të saj, Barrëdhënësit ideklorojnë dhe garantojnë Barrëmarrësit se:

- a) janë zotërues të ligjshëm të Kuotave;
- b) Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej një milion Leke (1.000.000,00 Leke) në të cilin BLESSED INVESTMENT SH.P.K. zotëron një kuotë që përfaqëson 51% të kapitalit të regjistruar të Huamarrësit dhe MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K. zotëron një kuotë që përfaqëson 49% të kapitalit të regjistruar të Huamarrësit;



A2023051400081845206

- c) Kuotat e Shoqërisë janë emetuar në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme dhe Shoqëria ka bërë regjistrimet e nevojshme në lidhje me Kuotat në regjistrat përkatës, sipas kërkesave të ligjit në fuqi;
- d) Kuotat janë pjesë e kapitalit i cili është plotësisht i nënshkruar, i regjistruar dhe i paguar;
- e) me përjashtim të çfarë parashikohet në Marrëveshjen e Kredisë, nuk ka asnjë Barrë tjetër mbi Kuotat dhe nuk ka mbetur pezull as regjistrimi i ndonjë Barre, dhe as i veprimeve për krijimin, vendosjen apo regjistrimin e një Barre të ndërmarrë nga Barredhënesit, ose në dijeni faktike të Barredhënesve, apo të një personi tjetër;
- f) Ne lidhje me Barrën Siguruese:
- është krijuar dhe është dhënë në mënyrë të ligjshme nga Barrëdhënësit dhe do të Vendoset dhe Regjistrohet në mënyrë të vlefshme sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje dhe sipas radhëve të prioritetit të përcaktuara këtu, dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj janë të vlefshme dhe detyruese për Barrëdhënësit. "E dhënë dhe e krijuar" sipas kësaj dispozite, ka kuptimin e përcaktuar në nenin 5 të Ligjit për Barrët Siguruese;
 - është në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe
 - me përjashtim të çfarë parashikohet në Marrëveshjen e Kredisë, dhënia, krijimi Vendosja dhe Regjistrimi i Barrës Siguruese dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk shkelin dhe nuk janë në kundërshtim me ndonjë marrëveshje apo sipërmarrje tjetër në të cilën Barrëdhënësit janë palë ose ndonjë dispozite ligjore, vendim, dekret apo urdhër tjetër të çdo gjykate apo autoriteti publik, akteve të shoqërisë apo çdo dokument tjetër themelues të Barrëdhënësve;
- g) nuk ka asnjë pretendim me shkrim apo proces gjyqësor të në proces apo të paralajmëruar me shkrim, për të cilët Barrëdhënësit janë në dijeni, përpara çdo gjykate apo paneli arbitrazhi, në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, në lidhje me të drejtat e pronësisë mbi Kolateralin;
- h) dhënia, krijimi, vendosja dhe regjistrimi i Barrës Siguruese është pjesë e qëllimit dhe autoritetit të Barrëdhënësve dhe të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me dhënien, krijimin dhe regjistrimin e Barrës Siguruese janë marrë dhe ruajtur në fuqi dhe zbatim të plotë;
- i) Barrëdhënësit nuk janë në paaftësi paguese apo duke kryer procedura për mbyllje të aktivitetit, likuidimit, falimentimit apo ndonjë procedure tjetër të ngjashme dhe nuk është e parashikueshme në mënyrë të arsyeshme që as të kalojnë ndonjë nga procedurat e mësipërme;
- j) Barrëdhënësit kanë marrë një kopje dhe kuptojnë kushtet e Marrëveshjes së Kredisë
- k) Barrëdhënësit deklarojnë, garantojnë dhe merr përsipër ndaj Barrëmarrësit që përveç paragrafit (g), deklaratimet e mësipërme janë dhënë nga Barrëdhënës, duke konsideruar faktet dhe rrethanat e ekzistuese në datën e çdo Kërkese për Përdorim, datën e secilës Datë Përdorimi, ditën e parë të çdo Periudhe Interesi dhe në datën në të cilën është bërë ndonjë shpërndarje nga Barrëdhënësit.

Që nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe në datën e krijimit dhe Regjistrimit të saj, secila Palë përfaqëson dhe garanton Palën tjetër që:

l) është një shoqëri e themeluar siç duhet sipas ligjeve të juridiksionit të themelimit të saj dhe ajo ka dhe do të ketë në çdo kohë të drejtat e nevojshme për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.2. Besueshmëria dhe Saktësia

2.2.1. Secila Palë i garanton Palës tjetër se çdo deklaratë dhe garanci e zbatueshme për secilën Palë në Seksionin 2.1 është e vërtetë dhe e saktë që prej datës së lidhjes së Marrëveshjes dhe që prej datës së



A2021051400081845206

Vendosjes dhe Regjistrimit të saj dhe se asnjë deklaram dhe garanci nuk përjashton asnjë çështje që i bënë këto deklarata dhe garanci të pavërteta ose keqinformuese nga pikëpamja materiale;

- 2.2.2.** Barrëdhënësi pranon se Barrëmarrësi ka lidhur këtë Marrëveshje në mbështetje dhe në besim të plotë me çdo deklaram dhe garanci.

3. BARRA SIGURUESE DHE DETYRIMET E SIGURUARA

3.1. Vendosja dhe Regjistrimi i Barrës Siguruese

- 3.1.1.** Për të siguruar pagesën dhe përmbushjen me përpikëri të Detyrimeve të Siguruara, Barrëdhënësi me këtë Marrëveshje krijon në favor të Barrëmarrësit, një Barrë Siguruese sipas Ligjit për Barrët Siguruese mbi Kolateralin dhe merr përsipër me anë të kësaj Marrëveshje (dhe Barrëmarrësi jep këtu autorizimin e tij) të kompletojë, apo të mundësojë kompletimin nga ana e Shoqërisë, duke regjistruar këtë Barrë Siguruese në RBS, Vendosjen dhe Regjistrimin si barrë siguruese të radhës së parë mbi Kolateral sipas dhe në përputhje me përkufizimin përkatës në klauzolën 1.1 të kësaj Marrëveshjeje.
- 3.1.2.** Kolaterali do të shërbejë si Barrë Siguruese e radhës së parë në favor të Barrëmarrësit përgjatë gjithë Periudhës së Sigurisë.
- 3.1.3.** Barrëmarrësi autorizon këtu secilin prej Barrëdhënësve dhe Barrëdhënësit kanë detyrimin të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për Vendosjen dhe Regjistrimin e Barrës Siguruese mbi Kolateralin. Ky detyrim shtrihet edhe në lidhje me ndryshimet, zëvendësimin, rritjen, shtimin, zvogëlimin, heqjen nga Kolaterali që mund të dakordësohet midis Palëve herë pas here si dhe të sigurojë vazhdimësinë e Barrës Siguruese dhe të Kolateralit.
- 3.1.4.** Palët këtu bien dakord që Barrëmarrësi ka gjithashtu të drejtën (por jo detyrimin) të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm të parashikuar në, dhe për qëllimin e, paragrafit 3.1.3 më lart, të Vendosë dhe Regjistrojë si dhe mbrojë dhe të ruajë Kolateralin si dhe të përfitojë nga Barra Siguruese.
- 3.1.5.** Pa cenuar paragrafët 3.1.3 dhe 3.1.4 më lart, Barrëdhënësi në mënyrë të parevokueshme angazhohet që të nënshkruajë, dërgojë, regjistrojë dhe depozitojë çdo dokument në një formë të kënaqshme në mënyrë të arsyeshme për Barrëmarrësin për qëllimet e paragrafëve 3.1.3 dhe 3.1.4 me lart, dhe Barrëmarrësi ka të drejtë të marrë nga Barrëdhënësi kopjet origjinale të nënshkruara rregullisht, bashkë me çdo dokument, depozitim, njoftim, regjistrim, noterizim ose prove tjetër që duhet, sipas opinionit të arsyeshëm të Barrëmarrësit, për Vendosjen dhe Regjistrimin, për vlefshmërinë dhe radhën e preferimit të Barrës Siguruese.
- 3.1.6.** Deri në vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi, Barrëdhënësit do të kenë të drejtën e posedimit mbi Kolateralin. [për të marrë çdo të drejtë të ndërlidhur në masën e lejuar në Marrëveshjen e Kredisë,] dhe do të ushtrojnë të drejtat e votës për të cilat u lind e drejta prej pronësisë mbi kuotat (duke kuptuar që të drejtat e Barrëdhënësve mbi Kuotat nuk duhet të ushtrohen në një mënyrë që mund të ndikojë negativisht në vlerën e Kuotave ose të Huamarrësit, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, ose është në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë). Barrëdhënësit nuk mund të tjetërsojnë kolateralin.

3.2. Koha e zbatimit të të drejtave të Barrëmarrësit

- 3.2.1.** Barra Siguruese dhe të gjitha të drejtat e Barrëmarrësit të krijuara këtu do t'i bashkëngjiten në këtë datë çdo Kolaterali të zotëruar nga Barrëdhënësit, dhe menjëherë dhe automatikisht pasi Barrëdhënësit të jenë bërë zotëruar i çdo Kolaterali të përvetësuar prej tyre, , pas datës së kësaj



A2023051400081945206

Marrëveshjeje. Për aq sa do të jetë e nevojshme, me kërkesën e arsyeshme të Barrëmarrësit, Barrëdhënësit do të nënshkruajnë menjëherë, çdo marrëveshje për barrët siguroese, sipas formatit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo dokument tjetër apo do të kryejë çdo veprim tjetër që mund të jetë i nevojshëm me qëllim vendosjen e çdo apo të gjithë asetëve dhe të drejtave përbërëse të ardhshme të Kolateralit të zotëruara nga Barrëdhënësit përgjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Siguruar, si barrë në favor të Barrëmarrësit.

3.2.2. Të gjitha të drejtat e Barrëmarrësit e parashtruara dhe me kufizimet e parashikuara këtu, janë të përvokueshme përgjatë gjithë Periudhës së Sigurisë.

3.3. Detyrimet e Siguruara sipas Marrëveshjes

3.3.1. Kjo Marrëveshje ka për qëllim të sigurojë, dhe siguron, pagesën e plotë të të gjithë Detyrimeve të Siguruara.

3.3.2. Barra Siguroese jepet si barrë e shkallës së parë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës së Siguruar dhe do të renditet përpara çdo Barre dhe të drejte tjetër të palëve të treta.

3.3.3. Barra Siguroese nuk do të reduktohet në asnjë mënyrë për arsye të ndonjë ndërprerje në pagesa apo shlyerje të pjesshme të Detyrimeve të Siguruara.

3.3.4. Barra Siguroese do të ketë fuqi të plotë pavarësisht dispozitave të ndonjë garancie apo Barre tjetër, që mund të ketë qenë ose mund t'i jepet në çdo mënyrë dhe nga çdo person, Barrëmarrësit.

3.3.5. Pa cenuar detyrimet e Barrëdhënësve për të përdorur Kolateralin, Barra Siguroese nuk do të çlirohet ose të zvogëlohet ose afektohet në çdo mënyrë tjetër nga:

- a) ekzistenca e, ose vlefshmëria ose lëshimi i ndonjë Barre tjetër të marrë nga Barrëmarrësi sipas Marrëveshjes së Kredisë;
- b) përvec se kur parashikohet nga legjislacioni Shqiptar, çdo ndryshim, ose shtesë, kompromis apo çlirim i çdo Detyrimi të Siguruar, apo çdo ndryshim në ligj, rregulla apo rregullore të çdo juridiksioni, apo çdo veprim i ndonjë autoriteti apo gjykate që amendon, ndryshon, pakëson apo e afekton në çdo mënyrë tjetër ose që ka për qëllim të amendojë, ndryshojë, pakësojë apo afektojë në çfarëdo mënyre tjetër secilën nga Detyrimet e Siguruara;
- c) çdo amendament ose shtojcë, ose modifikim, riformulim apo zëvendësim i çdo dokumenti, i lidhur me Detyrimet e Siguruara (pavarësisht faktit nëse një amendament i tillë do të konsiderohet apo jo sipas legjislacionit të aplikueshëm si novacion (Përtëritje) e Detyrimeve të Siguruara) dhe në rast të tillë Barra Siguroese e krijuar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përfundojë po do të vazhdojë të sigurojë Detyrimet e Siguruara dhe ky paragraf 3.3.5 do të shërbejë si miratim i shprehur (marrë vesh shprehimisht) në përputhje me nenin 509 të Kodit Civil Shqiptar.
- d) çdo ekzekutim ose dështim për të marrë, përmbushur apo ekzekutuar ndonjë Barrë tjetër të marrë nga Barrëmarrësi sipas Marrëveshjes së Kredisë;
- e) për aq sa lejohet nga legjislacioni i zbatueshëm, çdo amendim, shtesë, modifikim apo ripërtëritje e Marrëveshjes së Kredisë;
- f) çdo lirim i plotë apo i pjesëshëm, dhënie kohe apo afati, apo çdo tolerim kundrejt Barrëdhënësve apo pale të tretë në lidhje me Barrë tjetër të krijuar në bazë të Marrëveshjes së Kredisë;
- g) çdo transferim, shitje apo transferim i një lloji tjetër (me anë të kontratës apo ligjit) i një ose të gjithë Detyrimeve të Siguruara nga Barrëmarrësi tek një palë e tretë.
- h) transferimi i të drejtave, (duke përfshirë por pa u limituar në zëvendësimin e debitorit sipas legjislacionit shqiptar) në lidhje me një ose të gjitha Detyrimet e Siguruara tek çdo palë e tretë (për të shmangur çdo



A2023051400081845206

Iloj dyshimi çdo transferim i të drejtave tek një palë e tretë i nënshtrohet dispozitave të Marrëveshjes së Kredisë); ose

- i) një ndryshim i formës ligjore të entitetit ligjor, ose një bashkim ose ndarje, ose çdo formë tjetër e riorganizimit dhe/ose ristrukturimit të Barrëmarrësit, Huamarrësit, Barrëdhënësve dhe/ose aktivitetit tregtar të Barrëdhënësve dhe/ose Huamarrësit (për shmangien e çdo dyshimi, çdo ndryshim i tillë, bashkim ose shkëputje, ose formë tjetër riorganizimi dhe/ose ristrukturimi dhe/ose aktiviteti tregtar në rastin e Barrëdhënësve u nënshtrohet dispozitave të Marrëveshjes së Kredisë).

3.4. Miratimi nga ana e Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri

3.4.1. Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje dhe e Barrës Siguruese kushtëzohet me marrjen e miratimit paraprak prej Barrëdhënësit dhe/ose Huamarrësit, nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) lidhur me të drejtën e Barrëdhënësit për të vendosur Barrë Siguruese mbi Asetet.

4. DETYRIMET E BARRËDHËNËSVE

- 4.1. Barra Siguruese mbi Kolateralin vendoset mbi të drejtat e Barrëdhënësve mbi këtë Kolateral, siç parashikohet në Ligjin për Barrët Siguruese dhe rradha e Barrës Siguruese mbi Kolateral përcaktohet nga data e regjistrimit të Barrës Siguruese në RBS.
- 4.2. Për sa kohë që Detyrimet e Siguruara nuk janë përmbushur, Barrëdhënësit:
 - 4.2.1. nuk do të ndërmarrin asnjë veprim:
 - a) i cili mund të dëmtojë, direkt ose indirekt, vlefshmërinë, efektshmërinë ose ekzekutueshmërinë e Barrës Siguruese ose të drejtat dhe interesat e Barrëmarrësit që rrjedhin nga kjo Marrëveshje; ose
 - b) që mund të dëmtojë vlefshmërinë ose ekzistencën e kësaj Marrëveshjeje.
 - 4.2.2. do të ndërmarrin, me shpenzimet e veta, të gjitha veprimet të cilat mund të jenë në mënyrë të arsyeshme të nevojshme për Palët Financiare, për të mbrojtur vlefshmërinë, efektshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të të drejtave të Barrëmarrësit mbi Kolateralin, përfshirë kundrejt pretendimeve të ngritura nga palë të treta në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kolateralin e dhënë këtu;
 - 4.2.3. me shpenzimet e veta, të nënshkruajnë në kohë dhe të dërgojnë të gjitha dokumentet dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet të cilat Palët Financiare mund të kërkojnë, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimin që
 - a) të regjistrojnë, përmbushin dhe mbajnë në fuqi dhe zbatim Barrën Siguruese; dhe
 - b) t'i japin mundësi Barrëmarrësit të ushtrojë të drejtat që i takojnë sipas Marrëveshjes, përfshirë por pa u kufizuar, të gjitha të drejtat e ushtrueshme me ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi; dhe
 - c) të nënshkruajnë, ekzekutojnë, pranojnë dhe dorëzojnë detyra të mëtejshme, transferime dhe dokumente që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në mënyrë që të zbatohet kjo Marrëveshje dhe të paguajë të gjitha kostot për kërkimet, regjistrimet dhe aplikimet;
 - 4.2.4. të mos ndryshojë formën e Shoqërisë
 - 4.2.5. përveç për sa lejohet në Marrëveshjen e Kredisë, nuk do të krijojë apo lejojë krijimin, mbi të gjithë apo në pjesë të ndonjë Kolaterali, të ndonjë Barre, qoftë të një rangu më të lartë ose në të njëjtin rang të prioritetit ose më të ulët, me Barrën Siguruese në këtë Marrëveshje;
 - 4.2.6. përveç për sa lejohet në Marrëveshjen e Kredisë, nuk do të transferojë ose disponojë në mënyrë tjetër të drejtat dhe interesat mbi Kolateralin;



A2023051400081845206

- 4.2.7. do të kryejë dhe përmbushë, ose bëjë të mundur kryerjen dhe përmbushjen e të gjitha afateve, detyrimeve dhe kushteve, që duhet të kryhen ose përmbushen prej tyre sipas kësaj Marrëveshje dhe Marrëveshjes së Kredisë për sa i përket Barrës Siguruese dhe Kolateralit;
- 4.2.8. lejojë çdo inspektim nga Barrëmarrësi të të gjithë informacionit mbi Kolateralin si dhe dokumentacionin e nevojshëm, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësit herë pas here;
- 4.2.9. nuk do të kryejë apo ndër marrë ndonjë veprim kryerja ose moskryerja e të cilit mund të ndikojë negativisht në vlerën e Kolateralit ose interesave të tjerë (duke përfshirë por pa u kufizuar në aftësinë e Barrëmarrësit për të ekzekutuar Barrën Siguruese pa asnjë kufizim) të Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshje; përveç për sa lejohet në Dokumentet Financiare, dhe
- 4.2.10. do t'i dërgojë Barrëmarrësit në kohë, të gjitha njoftimet jorutinë dhe dokumente të tjera që ka marrë në lidhje me Kolateralin, përfshirë por pa u kufizuar, pretendimet e shkruara nga palë të treta;

5. EKZEKUTIMI I BARRËS SIGURUESE

- 5.1. Me ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi dhe në çdo kohë më pas, Barra Siguruese, e krijuar sipas kësaj Marrëveshje do të bëhet e ekzekutueshme në mënyrë të menjëhershme dhe së bashku me çdo të drejtë apo mjet ligjor që i takon në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Kredisë apo për shkak të legjislacionit të aplikueshëm, Barrëmarrësi do të ketë të drejtën, të ushtrojë të gjithë të drejtat, kompetencat dhe mjetet ligjore për ekzekutimin e të gjitha të drejtave që një Barrëmarrës ka në kuptim të Ligjit për Barrët Siguruese.
- 5.2. Në çdo kohë pas ndodhjes së një Rasti Ekzekutimi, Barrëmarrësi do të ketë:
- të drejtën të ushtrojë gjitha të drejtat e mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas Ligjit për Barrët Siguruese, përfshirë të drejtën për të shitur Kolateralin dhe të drejtën për të paguar çdo mangësi ose dëm për të cilën Barrëmarrësi ka të drejtë sipas ligjit në fuqi; dhe
 - të drejtën të transferojnë, japin në favor të palëve të treta, ose disponojnë në çdo mënyrë tjetër Kolateralin apo pjesë të tij, sipas mënyrës, afateve dhe kushteve si dhe në afatin apo afatet që i lejohe nga Ligji për Barrët Siguruese.
- 5.3. Në rast se Barrëmarrësi do të ekzekutojë Barrën Siguruese sipas, dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, atëherë Barrëdhënësit do të ndihmojnë me shpenzimet e veta, në mënyrë të arsyeshme në përfitimin e shpejtë të të ardhurave apo të çdo pjese të tyre dhe/ose ushtrimin nga Barrëmarrësi të çdo të drejte tjetër sipas kësaj Marrëveshje.
- 5.4. Barrëdhënësit heqin dorë nga (i) çdo e drejtë për shmangien apo anulimin e kësaj Marrëveshjeje ose nga (ii) e drejta e tyre për të ngritur pretendime që ata apo Huamarrësi mund të kenë kundrejt Barrëmarrësit për secilën nga detyrimet e siguruara.

6. DELEGIMI

- 6.1. Pa cenuar paragrafin 3.1.1, Barrëmarrësi mund të delegojë nëpërmjet një prokure ose në një mënyrë tjetër çdo të drejtë ose diskreccion të ushtrueshëm nga Barrëmarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje kundrejt një pale të tretë (përfshirë çfarë përcaktohet në pikën 3.1). Çdo delegim i tillë mund të kryhet sipas afateve dhe kushteve (duke përfshirë të drejtën e nëndelegimit) që Barrëmarrësi e konsideron si të përshtatshme.
- 6.2. Me kusht që të jetë njoftuar me shkrim për një delegim të tillë nga Barrëmarrësi, Barrëdhënësit këtu pranojnë, njohin dhe bien dakord që do të konsiderojnë tetë konsiderojë të gjitha veprimet dhe aktet



A2023051400081845206

e ndërmarra nga, dhe të marra prej, një pale të tretë deleguar nga Barrëmarrësi në zbatim të kësaj Marrëveshje, si të ishin ndërmarrë nga Barrëmarrësi personalisht.

7. PROKURA

- 7.1. Pa cenuar paragrafin 3.1.1, Barrëdhënësit këtu caktojnë Barrëmarrësin dhe pranojnë që Barrëmarrësi të ketë të drejtën të delegojë të drejtat e përftuara nëpërmjet këtij caktimi tek (nëse ka) çdo i deleguar ose i nëndeleguar i referuar në paragrafin 6.1, si përfaqësues të tij të cilët do të kenë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet (duke përfshirë por pa u kufizuar në nënshkrimin e çdo dokumenti apo depozitimin pranë çdo regjistri, përfshirë Regjistrin e Barrëve Siguruese dhe çdo regjistër tjetër të zbatueshëm) të cilat Barrëdhënësit janë të detyruar t'i kryejnë sipas kësaj Marrëveshje. Caktimi në përputhje me sa më sipër do të bëhet efektiv me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje dhe do të jetë i zbatueshëm me efekt plotësues në lidhje me detyrimet e Barrëdhënësve sipas kësaj Marrëveshje.
- 7.2. Barrëmarrësi pranon këtu caktimin në përputhje me paragrafin 7.1.

8. ZGJIDHJA DHE ÇLIRIMI I BARRËS SIGURUESE

- 8.1. Të drejtat e Barrëmarrësit që rrjedhin nga kjo Marrëveshje do të përfundojnë kur të gjitha Detyrimet e Siguruara të jenë shlyer plotësisht.
- 8.2. Pasi të gjitha Detyrimet e Siguruara, të jenë shlyer në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar tërësisht, Barrëmarrësi në bazë të kërkesës dhe me kostot dhe shpenzimet e Barrëdhënësve, do të lirojnë Kolateralin duke lëshuar apo plotësuar çdo dokument ose deklaratë/formular lirim të nevojshme dhe në këtë mënyrë do të lirojnë Barrën Siguruese me kusht që ky lirim të mos jetë bërë në bazë të një pagese, mase siguruese, ose mjeti tjetër që është i pavlefshëm ose që do të ripaguhet mbrapsht si pasojë e procedurave të falimentit, likuidimit ose çdo procedure tjetër në bazë të legjislacionit shqiptar, Barra Siguruese dhe kjo Marrëveshje do vazhdojnë të ekzistojnë sikur ky lirim i kryer sipas nenit 8 të mos ketë ndodhur.
- 8.3. Në varësi të kufizimeve të pikës 8.2 më lart, Barrëdhënësit do të jenë përgjegjës për të gjitha depozitimet dhe regjistrimet, përfshirë depozitimin dhe regjistrimin e dokumentit ose deklaratës/formularit të liritimit për qëllimin e liritimit të Barrës Siguruese.

9. SHPENZIMET

9.1. Kostot e Transaksionit

- 9.1.1. Barrëdhënësit brenda 30 ditëve nga kërkesa e Barrëmarrësit do të paguajnë Barrëmarrësin për të gjitha kostot e arsyeshme, tarifatat dhe shpenzimet e dokumentuara (përfshirë, pa u kufizuar, shpenzimet ligjore) në lidhje me krijimin, regjistrimin, kompletimin dhe ruajtjen e Barrës Siguruese, ekzekutimit me çdo mjet të njëres nga dispozitat e Marrëveshjes apo të ushtrimit të çdo të drejte, kompetence apo mjeti ligjor të parashikuar këtu apo në Ligjin për Barrët Siguruese, deri në shumat e rënë dakord me Barrëdhënësit herë pas here, me kusht që pëlqimi paraprak i Barrëdhënësve të mos (i) të mbahet ose të vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe/ose (ii) të kërkohet nëse një Mospërbushje ka ndodhur dhe po vazhdon) i ndodhur nga Palët Financiare në lidhje me vlerësimin, negocimin, përgatitjen, shtypjen, përsosjen, ekzekutimin dhe administrimin dhe monitorimin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo dokumenti tjetër të përmendur në këtë Marrëveshje.



A202305140008184S205

9.2. Kostot e Vazhdueshme

- 9.2.1. Nëse ndonjë prej Barrëdhënësve kërkojnë një ndryshim, heqje dorë ose pëlqim, Barrëdhënësit, brenda (5) pesë Ditëve të Punës nga kërkesa, do të rimbursojnë Barrëmarrësin për shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të dokumentuara (duke përfshirë tarifat ligjore dhe shpenzimet) të bëra nga Barrëmarrësi në përgjigje, vlerësim, negociim ose përmbushje të kërkesës ose kushteve.
- 9.2.2. Nëse pas datës së kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë Financiare ndërmerr ndonjë kosto ose kryen ndonjë shpenzim të dokumentuar (përfshirë, pa u kufizuar në tarifat ligjore dhe/ose të konsulencës) në lidhje me krijimin, regjistrimin, plotësimin ose ruajtjen e kolateralit, deri në shumën të rënë dakord me Barrëdhënësin herë pas here, me kusht që pëlqimi paraprak i Barrëdhënësve të mos i) mbahet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe/ose (ii) kërkohet nëse një Mospërmbushje ka ndodhur dhe po vazhdon) në lidhje me administrimin dhe monitorimin e kolateralit, ose çregjistrimin e kolateralit, Barrëdhënësit do të rimbursojnë këtë Palë Financiare për shumën e kostove dhe shpenzimeve brenda tri Ditëve të Punës nga kërkesa.

9.3. Kostot e Ekzekutimit

- 9.3.1. Barrëdhënësit, brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga kërkesa, do t'i paguajnë secilës Palë Financiare shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë tarifat ligjore dhe shpenzimet) të bëra nga ajo Palë Financiare në lidhje me zbatimin ose ruajtjen e të çdo të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo procedimi të nisur nga ose kundër Barrëmarrësit si pasojë e marrjes ose mbajtjes së Barrës Siguruese ose zbatimit të këtyre të drejtave.

10. MJETET LIGJORE JO PËRJASHTUESE

- 10.1. Të gjitha të drejtat, kompetencat dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje nuk zëvendësojnë por janë shtesë e çdo forme sigurimi që mbahet ose mund të mbahet nga Barrëmarrësi dhe çdo e drejtë, kompetencë dhe mjet ligjor i Barrëmarrësit, pavarësisht nga forma se si kanë lindur ose janë krijuar.

11. DËMSHPËRBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

11.1. Detyrimet e Barrëmarrësit

Përveç dëmeve të shkaktuara nga neglizhenca e rëndë apo veprimi me dashje, Barrëmarrësi nuk do të ketë përgjegjësi për dëmet që i shkaktohen Barrëdhënësve gjatë ushtrimit apo mos-ushtrimit të të drejtave, veprimeve ose mjeteve ligjore që i lejojnë atyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.2. Taksat dhe Shpenzimet

Pavarësisht Klauzolës 12.5 (Taksat e pullave) të Marrëveshjes së Kredisë, të gjitha detyrimet, taksat, dhe tarifat e tjera, duke përfshirë por pa u kufizuar në, tarifën e vulës, taksën e regjistrimit në gjykatë, dhe tarifa noteriale, shpenzime, disbursime dhe detyrimet të cilat do të bëhen të pagueshme në lidhje me përgatitjen, negociimin, përfundimin, dërgimin, regjistrimin, depozitimin, kompletimin, zbatimin, përmbushjen, ndryshimin, heqjen dorë, miratimin, lirimin, ruajtjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Barrës Siguruese do të mbulohen nga Barrëdhënësit.



A2023051400081845206

12. AFATI DHE PËRFUNDIMI

- 12.1 Kjo Marrëveshje është e vlefshme deri në përfundim të Periudhës së Sigurisë.
- 12.2 Kjo Marrëveshje konsiderohet e përfunduar me mbarimin e Periudhës së Sigurisë dhe çlirimin e Barrës Siguruese.

13. KOMUNIKIMET

13.1. Forma e Njoftimeve

Modalitetet dhe format e njoftimit do të bëhen në përputhje me Klauzolën 29 (Njoftimet) të Marrëveshjes së Kredisë, e cila do të konsiderohet pjesë e kësaj Marrëveshje dhe është e zbatueshme këtu me anë të referencës në këtë paragraf 13.1.

14. DISPOZITA TË NDRYSHME

14.1. Ndryshimet dhe Heqja Dorë

Asnjë prej kushteve të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të ndryshohet përveç se me shkrim dhe miratuar nga të gjitha Palët. Barrëmarrësi ka të drejtën dhe diskrecionin të japin kohë shtesë dhe privilegje të tjera, kompromise, të bjerë dakord për çlirimin apo shlyerjen dhe të trajtojnë Barrëdhënësit dhe Kolateralin siç Barrëmarrësi e mendon të përshtatshme, dhe ushtrimi i këtij diskrecioni nuk do të nënkuptojë në asnjë mënyrë heqjen dorë nga, ose ezaurimn e të drejtave të Barrëmarrësit dhe këto të drejta mund të ushtrohen në çdo moment nga Barrëmarrësi.

14.2. Pasardhësit

Kjo Marrëveshje është e detyrueshme për Barrëdhënësit dhe pasardhësit e tij dhe do të shërbejë në favor të Barrëmarrësit dhe pasardhësve dhe përfituesve të tij.

14.3. Transferimi i të drejtave

- 14.3.1. Barrëdhënësit nuk mund të cedojnë asnjë nga të drejtat e tij ose të transferojë asnjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 14.3.2. Kjo Marrëveshje dhe të drejtat dhe detyrimet e Barrëmarrësit sipas saj do të jenë të transferueshme dhe të përcaktueshme nga Barrëmarrësi, pa asnjë pretendim ose kundërshtim nga Barrëdhënësit në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë.

14.4. Mjetet ligjore kumulative

- 14.4.1. Të drejtat, kompetencat dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk janë, dhe as nuk interpretohen, si të drejta, kompetenca apo mjete ligjore ekskluzive të parashikuara nga ligji apo diçka tjetër, dhe mund të ushtrohen herë pas here dhe sa herë që Barrëmarrësi e gjykon të përshtatshme.
- 14.4.2. Asnjë vonesë apo mos-ushttrim i drejtave apo mjeteve ligjore që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje, nga ana e Barrëmarrësit, nuk do ta dëmtojë këtë të drejtë apo mjet ligjor ose nuk do të konsiderohet si heqje dorë prej saj, dhe as ushtrimi i vetëm, i pjesshëm ose i gabuar i ndonjë te drejtë apo mjeti ligjor



A2023051400081845206

nuk ndalon ushtrimin e mëtejshëm të asaj të drejte apo mjete ligjor apo të ndonjë tjetër te drejte apo mjete ligjor që rrjedh nga kjo Marrëveshje.

14.5. Marrëveshja e Barrës Siguruese

- 14.5.1.** Barrëdhënësit pranojnë se kjo Marrëveshje përbën një "Marrëveshje për Barrë Siguruese" për qëllimet e Nenit 2 të Ligjit mbi Barrët Siguruese dhe një "titull ekzekutiv" për qëllime të Ligjit Shqiptar.
- 14.5.2.** Çdo deklaratë, certifikatë ose vendim i Barrëmarrësit për Detyrimet e Siguruara ose (pa kufizim) për çdo çështje tjetër të parashikuar në këtë Marrëveshje, në mungesë të shfaqjes së ndonjë gabimi, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Barrëdhënësit.

14.6. Pavlefshmëria e Pjesshme

Nëse në çdo kohe një ose më shumë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose shfuqizohet në çdo kuptim sipas çdo ligji apo juridiksioni, as ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe as ligjshmëria, vlefshmëria, apo zbatueshmëria e kësaj dispozite sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër nuk do të ndikohet apo dëmtohet si rezultat i kësaj. Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme por mund të bëhet e vlefshme nëse pjese të saj fshihen, dispozita në fjalë do të zbatohet me ndryshimet që mund të jenë të nevojshme për ta bërë atë të vlefshme.

14.7. Publikimi i të dhënave

Barrëdhënësit këtu japin dhe vënë në dispozicion çdo leje, pëlqim dhe autorizim në favor të Barrëmarrësit dhe çdo Palë tjetër Financiare, siç lejohet nga Huamarrësi në Klauzolën 35.2 (Zbulimi i Informacionit Konfidencial) të Marrëveshjes së Kredisë.

15. VAZHDIMËSIA E BARRËS

- 15.1.** Barra Siguruese e krijuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë e vazhdueshme dhe nuk do të konsiderohet si e shlyer ose e çliruar nga ndonjë pagesë e ndërmjetme ose shlyerje e të gjitha Detyrimeve të Siguruara apo e një pjesë të tyre, apo diçka tjetër, dhe do të jetë detyruese deri sa e gjithë vlera e Detyrimeve të Siguruara të jetë paguar dhe shlyer plotësisht, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme.

16. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 16.1.** Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe palët do t'i drejtohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17. DATA E HYRJES NË FUQI

- 17.1.** Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së pëlqimit paraprak nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, siç parashikohet në nenin 3.4 të kësaj Marrëveshjeje.

18. KOPJET



A2023051400081845206

18.1. Kjo Marrëveshje është hartuar në 3 (tre) kopje, Në rast mospërputhje midis versionit në anglisht dhe atij në shqip, versioni në anglisht do të ketë përparësi.

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrë të rregullt, pasi janë njohur me përmbajtjen dhe përkthimin përkatës, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emrat e tyre përkatës, në datën dhe vitin siç përcaktohet më lart, përpara Noterit, në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

BARRËDHËNËSIT

BLESSED INVESTMENT SH.P.K.,

përfaqësuar nga

Ana Lleshi

Ana Lleshi



MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.

përfaqësuar nga

Ida Mezini

Ida Mezini



BARRËMARRËSI

GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIF

përfaqësuar nga

Aigest Milo

Aigest Milo



NOTERI

[Signature]



**SECURING CHARGE AGREEMENT
OVER SHARES**

between

**BLESSED INVESTMENT SH.P.K.,
MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.**

as **Chargors**

and

GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV - SIF

as **Chargee**

On this day, on 24/02.2023, in Tirana, Alket Mançka, in front of me the Public Notary were presented the following parties which will sign this Securing Charge Agreement as per below.

This Securing Charge Agreement (hereinafter as the “**Agreement**” or the “**Securing Charge Agreement**”) is made in Tirana by and between:


BLESSED INVESTMENT SH.P.K., a limited liability company duly incorporated under the laws of Albania, registered with the Government of Albania under number L71423028S and having its registered office at Str. Themistokli Gërmenji, No 6, Floor 1, Tirana, 1001, Albania, represented herein by the legal representative **Ana Lleshi**, bearer of ID card with number 036384557 and personal number: I15507055G;

and

